



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 28 Gusht 2023

Nr: 740

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT REGJISTRUAR ME NR. 403 ID ME KËRKUES
KOALICION PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA, PËR SHKELJE
ADMINISTRATIVE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ
2023**

Sot më datë 28 Gusht 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Koalicion për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara

SUBJEKT: Kryeministri
Zv. Kryeministri
Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

OBJEKT: Shqyrtim administrativ për shkelje administrative në kundërshtim me parashikimet e nenit 91, të Kodit Zgjedhor

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Më datë 08.05.2023, është administruar denoncimi i përcjellë nga Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, regjistruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me nr. regjistri 403 ID.

Denoncimi është administruar, në adresën e e-mail-it, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nëpërmjet raportit XVI i Koalicion për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, nëpërmjet së cilit pretendohet se: *“Kryeministri z. Edi Rama, Zv. Kryeministri dhe Ministri i Energjisë dhe Infrastrukturës, njëkohësisht Drejtuese Politike e Qarkut të Dibrës e Partisë Socialiste zj. Belinda Balluku dhe Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale zj. Ogerta Manastirliu, kanë zhvilluar një takim me mjekët dhe infermierët e Klosit dhe Matit, i cili figuron i pa raportuar, nga asnjë prej institucioneve drejtuesit e të cilave ishin në takim. Në takim kanë qenë prezentë mjekë dhe infermierë të veshur me përparësen e bardhë si dhe kandidati i Partisë Socialiste për Kryetare në Bashkinë Klos zj. Valbona Kola, e cila në profesion është mjekë. Në postimet e këtij aktiviteti në Facebook nga Kryeministri, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrja e Energjisë dhe Infrastrukturës njëkohësisht dhe Zv. Kryeministrja janë vendosur sloganet elektorale të Partisë Socialiste: #VetëmPërpara → #KurrëMëMbrapa. Nga fjalimet e Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe të Kryeministrit, në takim bëhet një paraqitjeve e arritjeve të qeverisë sidomos në fushën e shëndetësisë, me një fokus të veçantë në rritjen e pagave”.*

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t’u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Për shkak të kompleksitetit të çështjes, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet vendimit nr. 686, datë 08.07.2023 “Për zgjatjen e afatit të denoncimeve regjistruar me nr. 402 ID dhe 403 ID, për shkelje administrative për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”, ka vendosur zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit nr. 403 ID.

- Nëpërmjet denoncimit regjistruar me **nr. 403 ID**, denoncuesi pretendon se:

“Më datë 03.05.2023 Kryeministri z. Edi Rama, Zv. Kryeministrja dhe Ministrja e Energjisë dhe Infrastrukturës, njëkohësisht Drejtuese Politike e Qarkut të Dibrës e Partisë Socialiste zj. Belinda Balluku dhe Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale zj. Ogerta Manastirliu kanë zhvilluar një takim me mjekët dhe infermierët e Klosit dhe Matit. KRIIK nuk ka arritur të gjejë në ndërfaqen e

raportimeve një njoftim për këtë aktivitet, pra figuron të jetë i pa raportuar, nga asnjë prej institucioneve drejtuesit e të cilave ishin në takim.

Njoftimi për zhvillimin e kësaj veprimtarie është postuar në profilin zyrtar të Kryeministrit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe dhe Mbrojtjes Sociale , si dhe të dy ministreve.

Konkretisht:

Postimi në faqen e Kryeministrit Z. Edi Rama (më poshtë përmbajtja dhe foto/printscreens e faqes):
“Me mjekët dhe infermierët e Klosit dhe Matit për të bashkëbiseduar për planin 2-vjeçar të rritjes së pagave që ka filluar të jetësohet dhe përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore, për t’i krijuar stafeve mjekësore mundësinë për ta ushtruar me dinjitet profesionin e tyre fisnik.

#VetëmPërpara

#KurrëMëMbrapa”

Postimi video në faqen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (më poshtë përmbajtja dhe foto/printscreens e faqes):

“Me mjekët dhe infermierët e Klosit dhe Matit për të bashkëbiseduar për planin 2-vjeçar të rritjes së pagave që ka filluar të jetësohet dhe përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore, për t’i krijuar stafeve mjekësore mundësinë për ta ushtruar me dinjitet profesionin e tyre fisnik”

#VetëmPërpara

Postimi foto në faqen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (më poshtë përmbajtja dhe foto/printscreens e faqes):

“Sot takova zonjat profesioniste mjekë dhe infermiere të qendrës shëndetësore #Klos dhe stafin e mrekullueshëm të qendrave shëndetësore dhe spitalit të Matit, të cilët bëjnë një punë të jashtëzakonshme për t’i shërbyer me cilësi qytetarëve.

Me Kryeministrin Edi Rama dhe Zv/Kryeministren Belinda Balluku ndamë me mjekët dhe infermierët lajmin e mirë të rritjes së pagave me planin 2-vjeçar që fuqizon burimet tona njerëzore “

Postimi në faqen e Zv. Kryeministres dhe Ministres së Energjisë dhe Infrastrukturës, znj. Belinda Balluku (më poshtë përmbajtja dhe foto/printscreens e faqes):

Me mjekët dhe infermierët e Klosit dhe Matit

Me mjekët dhe infermierët e Klosit dhe Matit për të bashkëbiseduar për planin 2-vjeçar të rritjes së pagave që ka filluar të jetësohet dhe përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore, për t’i krijuar stafeve mjekësore mundësinë për ta ushtruar me dinjitet profesionin e tyre fisnik

#VetëmPërpara

#KurrëMëMbrapa

Gjithashtu zhvillimi i takimit është njoftuar edhe në Faqen Zyrtare të Internetit të Institucionit të Kryeministrit (më poshtë titulli i artikullit dhe foto/printscreens e faqes):

“Klos, me mjekë dhe infermiere të përkushtuar të zonës për planin 2-vjeçar të rritjes së pagave dhe përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore”,

Është njoftuar edhe në Faqen Zyrtare të Internetit të Institucionit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (më poshtë titulli i artikullit dhe foto/printscreens e faqes):

“Rama-Manastirliu: Për mjekët e familjes rritje page me 20 mijë lekë dhe infermierët me 15 mijë lekë brenda 2024”.

Ky takim është transmetuar LIVE edhe nga media disa media, si psh: Klan Neës (më poshtë foto/video shoot): Referuar postimeve në faqet zyrtare në Facebook, ku videot janë LIVE, por edhe transmetimit LIVE në media, data e zhvillimit të aktivitetit është data 03.05.2023 në orën 12.00.

Në takim kanë qenë prezentë mjekë dhe infermierë të veshur me përparësen e bardhë. Gjithashtu në takim ka qenë edhe kandidatja e Partisë Socialiste për Kryetare në Bashkinë Klos znj. Valbona Kola, e cila në profesion është mjekë. Në postimet e këtij aktiviteti në Facebook nga Kryeministri, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Shëndetësisë dhe Zv. Kryeministrja janë vendosur sloganet elektorale të Partisë Socialiste: #VetëmPërpara → #KurrëMëMbrapa

Nga fjalimet e Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe të Kryeministrit, në takim bëhet një paraqitjeve e arritjeve të qeverisë sidomos në fushën e shëndetësisë, me një fokus të veçantë në rritjen e pagave.

Evidentohet se Ministria e Shëndetësisë, në fund të fjalimit të saj është shprehur: “... Në fund dua të falënderoj nga zemra të gjithë ju, por veçanërisht doktoreshë Valbonën, e cila për 36 vite, së bashku me të gjithë ju këtu, ka ofruar kujdes shëndetësor për banorët e Klosit dhe tani do të marrë një stafetë të re për një mision të ri në shërbim të qytetarëve. Jo vetëm për sistemin shëndetësor por jam e bindur që një herë mjek e je gjithmonë mjek, nuk mund ta lësh këtë mision tëndin, por në shërbim të qytetarëve jam e bindur që do të bëjë akoma më shumë për Klosin që duam.”

Në gjykimin e KRIIK, aktiviteti, pavarësisht nëse është institucional apo në kuadër të fushatës zgjedhore, përbën përdorim të burimeve publike dhe autoritetit shtetëror në funksion të fushatës elektorale të Partisë Socialiste.

Kodi Zgjedhor në nenin 81, pika 3, jep kuptimin e një veprimtarie elektorale përgjatë fushatës zgjedhore, e konkretisht: “Veprimtaria ndjek qëllime elektorale kur ajo synon promovimin e arritjeve institucionale, të investimeve, inaugurimeve ose ecurinë në ndërtimin e punëve publike ose kur promovon aspekte specifike të programit elektorale të subjektit zgjedhor”.

Ndërsa në nenin 91 pika 1 dhe 2, Kodi Zgjedhor përcakton se: “Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.

2. Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore

kuptohehet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimit, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim”.

Lidhur me gjithë sa më sipër, edhe nëse kjo veprimtari do të pretendohet e konsiderohet si:

(B) si i karakterit institucional, atëherë evidentohen më poshtë këto shkelje:

Aktiviteti është i pa raportuar në ndërfaqen e KQZ.

Aktiviteti ka ndjekur qëllime elektorale prej Drejtuesëve të Institucioneve Qendrore, pasi zhvillohet përgjatë periudhës së fushatës zgjedhore. (“Veprimtaria ndjek qëllime elektorale kur ajo synon promovimin e arritjeve institucionale, të investimeve, inaugurimeve ose ecurinë në ndërtimin e punëve publike ose kur promovon aspekte specifike të programit elektorale të subjektit zgjedhor”)

Prania e Zv. Kryeministres dhe Ministres së Energjisë dhe Infrastrukturës, njëkohësisht Drejtuese Politike e Qarkut të Dibrës e Partisë Socialiste znj. Belinda Balluku nuk ka asnjë lidhje me natyrën e aktivitetit. Ndaj pjesëmarrja e saj evidentohet qartazi që është në funksion të pozicionit të saj si Drejtuese Politike e Partisë Socialiste duke i dhënë aktivitetit natyrë politike e elektorale.

Prania e kandidatës së Partisë Socialiste për Kryetare të Bashkisë Klos znj. Valbona Kola i jep aktivitetit natyrë elektorale.

Fjalimi i Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (si më sipër cituar) përbën përdorim të aktivitetit publik institucional, si dhe vendosje të institucionit që ajo përfaqëson, por edhe të institucioneve të tjera të përfaqësuara aty nga titullarët respektivë, në funksion të fushatës elektorale Kandidates për Kryetare Bashkie si dhe të Subjektit Zgjedhor “Partia Socialiste”.

Përdorimi i sloganëve elektorale të Partisë Socialiste në Faqet Zyrtare Institucionale, të Institucioneve dhe Titullarëve të tyre, jo vetëm përbën shpërdorim të burimeve dhe autoritetit shtetëror, por evidenton natyrën elektorale të aktivitetit institucional.

Referuar gjithë sa më sipër, në çdo rast të çfarëdo pretendimi të ngritur, në gjykimin e KRIIK, aktiviteti objekt denoncimi është zhvilluar në shkelje të kuadrit ligjor dhe si i tillë, nevojitet që KQZ-ja të sanksionojë titullarët e Spitalit të Klosit, titullarët e institucioneve të përfshira, si dhe Subjektin Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, e cila është përfituesja kryesore nga ky aktivitet”.

Më datë 5.11.2023 i është kërkuar informacion Kryeministres, Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministres së Energjisë dhe Infrastrukturës, subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” dhe Spitalit Mat.

Në vijim të hetimit administrative, u zhvillua seanca dëgjimore e datës 11 Maj 2023, ora 12:00, ku u ftuan palët në këtë proces për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

Në seancë u paraqitën përfaqësuesit e Kryeministres dhe përfaqësuesi i Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Përfaqësuesi i Kryeministres gjatë seancës pretendoi se organizatori i kësaj veprimtarie ka qenë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Aktiviteti i kryer ka pasur karakter teknik,

që i takon veprimtarisë institucionale të zyrave përkatëse dhe nuk ka pasur karakter politik, që cënon ligjshmërinë e procesit zgjedhor gjatë fushatës elektorale. Përsa i përket pjesëmarrjes së Zëvendëskryeministrit, zj. Balluku në këtë aktivitet, u sqarua se në këtë aktivitet nuk është e ftuar si drejtuese politike e qarkut të Dibrës, por ka qenë si drejtuese e grupit ndërministror për realizimin e planit 2-vjeçar të rritjes së pagave.

Përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sqaroi se pretendimet e palës denoncuese janë të pabazuara, përsa i përket pikave për përdorimin e burimeve njerëzore. Raportimi i administratës publike për programin e rritjes së pagave të personelit mjekësor në shkallë republike, është i drejtë dhe në përputhje me legjislacionin zgjedhor.

Në vijim të shqyrtimit administrativ, pas konsultimit me të gjitha provat dhe faktet, më datë 27 Korrik 2023 nëpërmjet postës elektronike, palëve në këtë proces i është kërkuar paraqitja e pretendimeve përfundimtare përpara se të vijohet me vendimmarrje. Personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për Spitalin Mat i është përgjigjur kërkesës sonë për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare, ku ndër të tjera bën me dije se: *“Aktiviteti për të cilin ju kërkonit shpjegime nuk është kryer në ambientet e Spitalit Bashkiak Mat”*. Personat e tjerë përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, palë në këtë proces administrativ në përfundim të afatit për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare nuk i janë përgjigjur kërkesës sonë për bashkëpunim.

Referuar dekontacionit nuk ka asnjë provë dhe asnjë fakt, të cilat provojnë pretendimet e kërkesit në lidhje me kërkesat e tyre. Përsa i përket mosraportimit të aktivitetit përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale sqaroi se faqja Web e raportimeve ka qenë në mirëmbajtje dhe personi përgjegjës për raportimin ka qenë në pamundësi për raportimin në kohë reale i këtij aktiviteti. Megjithatë, përfaqësuesi pretendon se aktiviteti nuk është një aktivitet i ndaluar për t’u zhvilluar mbi të gjitha dhe nuk është se ka ardhur ndonjë pasojë ose problematikë nga mosraportimi.

Pas administrimit të provave si dhe pretendimeve të palëve në këtë proces administrativ, vlerësoj se:

1. Aktiviteti i mësipërm, regjistruar me nr regjistri **nr. 403 ID**, referuar pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor ku përcaktohet se *“Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”*, përbën veprimtari publike dhe mbart detyrimin për raportim në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dedikuar për këtë qëllim.
2. Referuar pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor *“Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të gjitha veprimtaritë me karakter publik, që*

planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve”, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si institucioni organizator i kësaj veprimtarie publike, ka pasur detyrimin për raportim në ndërfaqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Megjithatë, gjatë seancës nga ana e përfaqësuesit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është pretenduar se mosfunksionimi i ndërfaqes së raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ka bërë të pamundur përmbushjen e këtij detyrimi. Për këto arsye, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerësoj se duhet të mirëkuptohet situata e krijuar, e cila del jashtë kontrollit të organit publik subjekt i këtij denoncimi, dhe të pushohet hetimi administrativ, përsa i përket shkeljes së nenit 92, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 4, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, për mospërmbushje të detyrimit për raportimit.

3. Denoncuesi pretendon se aktiviteti i kryer nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me pjesëmarrjen e Kryeministrit dhe Zvendëskryeministrit, me mjekët e bashkisë Klos, është aktivitet i cili i ka shërbyer kandidatit për kryetar bashkie në bashkinë Klos, pasi gjatë këtij aktiviteti dhe ka pasur thirrje me përmbajtje elektorale.
4. Neni 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor përcakton qartazi se, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, **nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor**, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”.
5. Në zbatim të neneve 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor, Komisioni Rregullator i ka nxjerrë vendimin nr. 9, datë 24.12.2020. Çdo dispozitë e tij duhet të lexohet në kuadër të kërkesave dhe qëllimeve që kanë këto nene. Qëllimi i dispozitës është që të garantojë paanshmëri dhe trajtim të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për **mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime zgjedhore**. Vendimi nuk ka për qëllim të ndalojë funksionimin normal të institucioneve shtetërore dhe as të ndalojë procedura normale administrative që kryejnë këto institucione.
6. Referuar nenit 3, pika 1.3, shkronja ”c” e këtij vendimi, parashikohet se vënia **në dispozicion e asetëve të luajtshme dhe të paluajtshme** të parashikuara në nenin 142, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, **për qëllime zgjedhore**, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, apo çdolloj enti tjetër ku shteti

zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, **përbën përdorim të burimeve publike.**

7. Pas shqyrtimit të materialit video të administruar si provë gjatë hetimit administrativ, u vlerësua se aktiviteti i zhvilluar ka pasur natyrë tërësisht institucionale dhe ka qenë në përmbushje të detyrimeve funksionale të pjesëmarrësve në këtë aktivitet. Pjesëmarrja e zj. Balluku, pavarësisht statusit të saj, vlerësojmë se ka qenë në përputhje me karakterin e aktivitetit, pasi ajo mban ndër të tjerash edhe pozicionin e zvendëskryeministrit.
8. Nga verifikimi i rrethanave dhe fakteve dhe nga këqyrja e materialeve video, nuk rezulton që në këtë aktivitet janë mbajtur deklarime apo thirrje elektorale nga asnjë prej pjesëmarrësve. Pjesëmarrja e deputetit, ministrit, kryeministrit jo domosdoshmërisht e kthen aktivitetin e një institucioni publik, në një aktivitet elektoral. Fjalimi me përmbajtje elektorale, logot, materialet propagandistike dhe çdo element tjetër, që mbart mesazhe elektorale, janë elementë që e kthejnë aktivitetin në të tillë.
9. Referuar nenit 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet se, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve publike, denoncuesi pretendon se ripostimi i materialit me përmbajtje elektorale në faqen zyrtare facebook të institucionit publik, përbën përdorim të burimeve publike. Përgjatë periudhës së shqyrtimit dhe hetimit administrativ të denoncimit të ardhur për shkelje administrative në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, janë evidentuar disa raste të përdorimit të burimeve publike në mënyrë indirekte nëpërmjet postimit apo ripostimit të materialeve me përmbajtje elektorale nga institucione publike. Pas vlerësimit objektiv të rrethanave dhe fakteve lidhur me këto denoncime është vendosur sanksionimi i subjekteve rast pas rasti. Çfarë është e rëndësishme të theksohet është se legjislatori nëpërmjet sanksionit nuk ka për qëllim vetëm të ndëshkojë subjektin, por edhe të sigurojë që të tjerët të mos kryejnë veprime të paligjshme. Prandaj, sanksionet janë pjesë e sistemit ligjor për të ruajtur rendin shoqëror dhe për të promovuar drejtësinë në një shoqëri demokratike. Sanksionet shërbejnë si mjet për të korigjuar sjelljen e individëve dhe për t'i ndihmuar ata të mësojnë nga gabimet e tyre dhe të ndryshojnë sjelljen e tyre në të ardhmen.
10. Të ndodhur në kushtet që në momentin e administrimit të denoncimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk arriti të sigurojë provën objekt shqyrtimi, pasi ky postim është fshirë menjëherë nga rrjetet sociale të subjekteve të denoncuara. Fakti që tashmë thuhet është kuptuar nga të gjithë institucionet që nuk mundet që në faqet e tyre të internetit apo në profilet e tyre zyrtare të rrjeteve sociale të publikojnë aktivitete elektorale përfshirë këtu edhe të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Kryeministrit, vlerësohet se

është e mjaftueshme për ta konsideruar këtë çështje të mbyllur dhe për të mos vendosur sanksion administrativ për sa kohë që është korrigjuar gabimi.

11. Nga sa u parashtrua më sipër, por edhe nga deklaratimet e palëve, evidentohet se institucionet publike kanë reaguar në mënyrë të menjëhershme duke vetë-rregulluar pasojat e mundshme të ardhura nga këto postimi dhe për rrjedhojë vlerësohet se duhet të pushohet shqyrtimi administrativ për denoncimin regjistruar me nr. 403 ID.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Moskonstatimin e shkeljes dhe pushimin e shqyrtimit administrativ ndaj:
 - Kryeministrit;
 - Zv. Kryeministrit dhe njëkohësisht Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë;
 - Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI